

VENDIM
Nr. 28, datë 17.1.2018

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT
RRUGOR SHQIPTAR**

(Ndryshuar me VKM nr. 21, datë 16.1.2019; nr. 455, datë 29.6.2022; nr. 79, datë 14.2.2024; nr. 137, datë 6.3.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili do të kryesohet nga z. *Ermal Nufi, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- a) *Z. Sokol Ismaili, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;*
- b) *Z. Renald Petriti, Ministria e Financave;*
- c) *Z. Ermal Elezi, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;*
- ç) *Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (riemërim);*
- d) *Z. Hazbi Parllaku, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;*
- dh) *Z. Gëzim Beqaj, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.*

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Vendimi nr. 1010, datë 13.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama